E mërkurë, 27 shtator 2023

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

[Të akuzuarit Thaçi dhe Krasniqi paraqiten përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare.

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur të gjithë. Vërej se z. Veseli dhe z. Selimi janë të pranishëm në sallën e gjyqit. Vërej më tej se z. Thaçi dhe z. Krasniqi na ndjekin përmes videolidhjes pas marrjes së lejes përkatëse.

Sot do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të Prokurorit 04781.

Megjithatë, para se të fillojmë me dëshminë, Trupi Gjykues do trajtojë kërkesën për zgjatje kohe, parashtrimi i protokolluar F01815, që është dorëzuar më 25 shtator 2023.

Mbrojtja kërkon zgjatjen e kohës për të dorëzuar përgjigjen e saj për mocionin e tretë të ZPS-së për pranim të

provave, në pajtim me rregullin 155 të 21 shtatorit 2023.

Mbrojtja parashtron se zgjatja e afatit është e rëndësishme për të siguruar të drejtat e të akuzuarve për të pasur kohë të mjaftueshme dhe për përgatitjen e Mbrojtjes në përputhje me nenin 21(2)(c) të Ligjit. Për pasojë, Mbrojtja kërkon zgjatjen e afatit për përgjigjen ndaj mocionit të ZPS-së deri të premten 27 tetor.

Për të trajtuar më shpejt këtë çështje, do të doja të ftoja ZPS-në të thoshte në qoftë se do ta kundërshtonte kërkesën për zgjatje të afatit pjesërisht apo plotësisht.

Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mendoj që e kemi diskutuar këtë ndërmjet palëve, *inter partes*, megjithatë ne nuk kemi problem me zgjatjen e afatit për një javë. Megjithatë data 27 tetor është afat shumë i gjatë për neve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, doni të thoni diçka?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe, shkurtimisht sepse e kemi kërkesën.

Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ju e keni kërkesën tonë. Ju e kuptoni sa punë na duhet të bëjmë ne përditë. Kështu që thjesht e kemi të nevojshme që të kemi kohën e përshtatshme për të trajtuar siç duhet mocionin e ZPS-së.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë?

Z. Tully?

Z. TULLY: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykues jep këtë urdhër me gojë.

Trupi Gjykues konstaton si më poshtë.

Trupi Gjykues mendon se Mbrojtja ka demonstruar arsye bindëse për zgjatjen e kohës duke pasur parasysh volumin e materialit përkatës, rëndësinë e çështjeve që mbulohen nga ky dokument. Gjithashtu edhe afatet kohore të cilat kanë të bëjnë me veprimtaritë për përgatitjen e procesit gjyqësor.

Trupi Gjykues më tej konstaton që miratimi i zgjatjes së afatit për Mbrojtjen, nuk cenon palët e tjera dhe pjesëmarrësit, dhe nuk shkakton vonesë të procesit gjyqësor.

Megjithatë, Trupi Gjykues mendon që zgjatja e afatit deri më datë 27 tetor 2023 është e tepërt, dhe do të vononte zgjidhjen e çështjes.

Kështu që, në pajtim me rregullat 40(2) të Ligjit, dhe rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Trupi Gjykues do ta zgjasë afatin për ekipet e Mbrojtjes për t'iu përgjigjur mocionit të ZPS-së deri më datë 17 tetor 2023.

Trupi Gjykues gjithashtu miraton *proprio motu* zgjatjen e afatit për ZPS-në për t'iu kundërpërgjigjur përgjigjes së ekipeve të Mbrojtjes deri më 31 tetor 2023.

Ky është fundi i urdhrit të parë gojor.

Tani jemi gati për të vijuar më tej.

Znj. Sekretare, për mbrojtjen e dëshmitarëve, ju lutem të na kaloni në seancë private.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni diçka për të thënë, Prokuror?

Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përfunduam për sot, ju faleminderit për praninë, për efikasitetin. Do ta

mbyllim deri në seancën e ardhshme të planifikuar. Ju faleminderit.

--- Seanca mbyllet në orën 09.59